



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari
Departament za Vinogradarstvo i Vinarstvo
Department for Vineyards and Wine

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	08.2/93/2017
PËR/ZA/TO:	Kompanive prodhuese të verës dhe SHVK "Enologjia"
CC:	z.Bekim Hoxha, Drejtor i Departamentit për Vreshtari dhe Verëtari
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Ylber Kuçi, Shef i Divizionit të Verëtarisë <i>Ylber Kuçi</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për deklarimin e projeksonit të prodhimit të verërave Cilësore dhe Kulminante nga vjelja e vitit 2017
Datë:	13.12.2017

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-019 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-8, për Verërat dhe U.A. 24/2008, mbi regjistrat e brendshëm dhe të jashtëm të Ndërmarrjeve prodhuese të rrushit, verës dhe prodhimeve nga rrushi e vera, bazuar në neni 3, pika b) dhe U.A. 01/2017 Për regjistrin e vreshtave, deklarimet e obligueshme, dokumentet përcjellëse dhe evidencat në bodrumet e verës Neni 10 pika 2 e këtij Udhëzimi Administrativ.

Departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë kërkon nga ju të bëni deklarimin e projeksonit të prodhimit të verërave Cilësore dhe Kulminante dhe sasisë së lëngut që do ta dërgoni për destilim nga prodhimi i vitit 2017. Deklarimi fillon të bëhet nga data 11 Dhjetor 2017 deri më datën 15 Janar 2018.

Faqe 1 nga 2

Adresa: Ndërtesa e ish Partive Politike, Rruga "Nënë Tereze" nr.35, 10.000 Prishtinë-Kosovë

Ky formular duhet të sillet në D.V.V. në Rahovec i nënshkruar dhe i vulosur.

Dorëzimi i formularit është kusht që vera ti nënshtrohet vlerësimit zyrtar (degustimit) të certifikohet dhe të merr të drejtën për tu vendosur në treg.

Data 15.01.2018 shënon fundin e deklarimeve pas të cilave nuk mund të bëhen ndryshime në sistem. Bashkangjitur keni mostrën e formularit si duhet të plotësohet si dhe formularin për plotësim për vjeljen e vitit 2017.

Sqarim:

Ju duhet që secilin varietet ta paraqitni sipas sasive që ju keni përpunuar. Të dhënat tuaja duhet ti përgjigjen sasisë së rrushit të grumbulluar. Pastaj gjatë përgatitjes së kërkesës në D.V.V. kur ju evidentoni produktet komerciale sistemi do ti merrë në mënyrë automatike. Njësia për Sasi të jetë në Hektolitra.

Formularët dorëzohen te zyrtari i lartë administrativo juridik z.Sadik Korenica për protokollim.

Për çdo sqarim jemi të gatshëm mos hezitoni.

Ju faleminderit.